

Udhërrëfyes

PËR FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË MOSHAVE 3-21 VJEÇ
PERGATITJA PËR RRUGËTIMIN TUAJ



– Klikoni në këto ikona për informacionin e zbatueshëm që mund t'ju nevojitet për rrugëtimin tuaj.



Lidhja do të jetë e disponueshme së shpejti!



Klasat 6-8

Distriktet shkollore janë të detyruara të hartojnë një plan suksesi për studentët që janë në rrezik të braktisjes së shkollës, bazuar në politikën e shkollës për këshillimin e karrierës.



Klasa e 9-të

Distriktet shkollore janë të detyruara të:

- hartojnë dhe mbajnë një plan diplomimi për të gjithë studentët që hyjnë në klasën e 9-të deri në klasën e 12-të
- njoftojnë prindin në çdo vit nëse studenti ka rrezik që të mos kualifikohet për diplomën e shkollës së mesme



Pika e shërbimit 2



Mosha 17-vjeçare

Distrikti shkollor duhet t'ju informojë ju dhe fëmijën tuaj për transferimin e të drejtave të fëmija pasi të mbushë moshën 18-vjeçare



Fëmija juaj ka arritur destinacionin e shkollës së mesme

Okul bōlgelerinin bir performans özeti sunması gerekir

1

Klasat PK-5

Asnjëherë nuk është shumë herët për të menduar për shpresat dhe ëndrrat që kenë për fëmijën tuaj; shikoni udhërrëfyesin e fëmijërisë së hershme për më shumë informacion.



2

Mosha 14-vjeçare

Distriktet shkollore duhet të krijojnë një Plan Tranzicioni në Planin Individual Arsivor (PIA) që hyn në fuqi kur studenti mbush 14 vjeç ose në moshë më të re nëse është e përshtatshme. Qytetarët e Ohios, që kanë aftësi të kufizuara, kanë të drejtë të aplikojnë për shërbime rehabilitimi profesional pranë agjencisë Opportunities for Ohioans with Disabilities



3

4

Pika e shërbimit 1



5

Mosha 16-vjeçare

Nëse fëmija juaj përfiton shërbime për aftësitë e kufizuara zhvillimore nga bordi i qarkut, në këtë moshë kualifikueshmëria rishikohet.



6



Mosha 18-vjeçare

Studenti ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të bërë disa zgjedhje ligjore dhe arsimore, që janë bërë nga prindërit në të kaluarën, si p.sh miratimi i PIA-së së tyre.

7

Mosha 22-vjeçare

Individët nuk e kanë më të drejtën e arsimit të përshtatshëm publik falas (FAPE) sipas Aktit Arsivor për Individët me



8



PERGATITJA PËR RRUGËTIMIN TUAJ

PËR ÇDO RRUGËTIM NEVOJITEN "BAGAZHE"

Ashtu si çdo udhëtim i mirë, planifikimi mund t'ju ndihmojë të bëni më shumë nga gjërat që dëshironi gjatë rrugës dhe ju ndihmon të shijoni udhëtimin. "Bagazhet e tranzicionit" tuaj përmbajnë shumë faqe interneti, burime dhe mjete për t'ju ndihmuar ju dhe fëmijën tuaj të përgatiteni për jetën pas shkollës së mesme. Ndërsa përgatiteni për rrugëtimin tuaj të tranzicionit, përdorni bagazhin tuaj dhe këtë Udhëzues të Tranzicionit për t'ju ndihmuar të planifikoni rrugëtimin tuaj. Duke ndjekur këtë Udhëzues Tranzicioni, ju do të jeni të mirëpërgatitur lidhur me përfundimin e shkollës dhe për progresin e fëmijës suaj drejt arsimit universitar.

- [Agency Navigation Tool](#) - Mjeti "Agency Navigation Tool" është një burim për të ofruar informacione bazë dhe në lidhje me agjencitë kryesore që mund të përfshihen në momentin e kalimit të rinjve në moshë madhore. Ky mjet është i dobishëm për të rinjtë, familjet e tyre, shkollat dhe agjencitë.
- [Udhëzuesi kuadër prindërit nga Career Connections](#) - Udhëzuesi kuadër i "Career Connections" shërben për të ndihmuar familjet që të ndikojnë dhe të ndërtojnë lidhjet lidhur me karrierën nga shtëpia.
- [Charting the LifeCourse](#) - Kuadri "Charting the LifeCourse" është një grup mjetesh të përdorura nga individët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, për të organizuar idetë, vizionet dhe qëllimet, si dhe për të zgjidhur problemet, për të gjetur dhe për të kërkuar mbështetje.
- [Disability Benefits 101](#) - Faqja e internetit "Disability Benefits 101" ju ofron mjete dhe informacion mbi punësimin, mbulimin shëndetësor dhe përfitimet. Individët mund të mësojnë se si puna dhe përfitimet integrohen së bashku.
- [Early Transition Planning](#) - Sa më herët që familjet dhe partnerët fillojnë të mendojnë për moshën madhore, aq më të përgatitur janë të rinjtë për atë që i pret në të ardhmen. Shikoni këtë faqe për burime, mbështetje dhe aktivitete që do të angazhojnë në mënyrë aktive këta të rinj rinj dhe do i ndihmojë që të fillojnë të mendojnë se si mund të jetë jetesa prej të rrituri sa më e kënaqshme për ta.
- [Parent Mentors](#) - Mentorët e prindërve në Ohio janë në dispozicion për të ndihmuar familjet të kuptojnë procesin dhe shërbimet e arsimit special për fëmijët e tyre. Në faqen e internetit të projektit të mentorëve të prindërve në Ohio nga "Ohio State University" dhe "Ohio Department of Education", do të gjeni një hartë të mentorëve të prindërve në Ohio, video dhe mjete për t'ju ndihmuar me përdorimin e procesin e arsimit special dhe ofron burime për të mësuar në shtëpi.
- [The Ohio Coalition for the Education of Children with Disabilities](#) - Koalicioni i Ohio-s për Arsimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara (OCECD) është një organizatë jofitimprurëse mbarëkombëtare që u shërben familjeve që kanë foshnja, fëmijë të vegjël dhe dhe të rinj me aftësi të kufizuara në Ohio, si dhe edukatorëve dhe agjencive që ofrojnë shërbime për ta.
- [Ohio Department of Education State Support Teams](#) - Në kuadër të Sistemit Shtetëror të Mbështetjes, Ekipi Shtetëror i Mbështetjes bashkëpunon me shkollat, familjet, partnerët rajonalë dhe Departamentin përmes një procesi përmirësimi të vazhdueshëm, për të garantuar që çdo fëmijë në Ohio do të ketë akses në arsim të cilësisë së lartë.
- [Rise Up](#) - "Rise Up" është një udhëzues i përgatitur nga organizata "Disability Rights Ohio" (DRO) për të rinjtë e moshës në tranzicion nga 14 deri në 21 vjeç. Udhëzuesi ka informacion të dobishëm rreth situatave që individët mund të kalojnë kur mbushin moshën madhore.
- [Llogaria STABLE](#) - Një llogari "STABLE" është një llogari investimi e disponueshme për individët e kualifikuar me aftësi të kufizuara. Llogaritë "STABLE" ju lejojnë të kurseni dhe investoni para pa humbur kualifikueshmërinë për disa programe të përfitimeve publike, si p.sh "Medicaid" ose "Supplemental Security Income" (SSI). Fitimet në llogarinë tuaj "STABLE" nuk i nënshtrohen tatimit federal mbi të ardhurat, për sa kohë që i shpenzoni ato për [shpenzimet lidhur me aftësinë e kufizuar përkatëse](#).
- [Statewide Family Engagement Center](#) - Qendra Shtetërore e Angazhimit Familjar në Ohio fuqizon studentët, prindërit, kujdestarët, drejtuesit e shkollave dhe partnerët e komunitetit për të krijuar marrëdhënie pozitive dhe angazhuese me njëri-tjetrin për të mbështetur suksesin arsimor të studentëve në ciklin parauniversitar (K-12).

KTHEHEMI TË UDHËRRËFYESI



Fëmija juaj është në klasat PK-5

Nuk është kurrë herët për të filluar të mendoni dhe të flisni mbi atë që shpresoni për të ardhmen e fëmijës suaj.

- Ndërhyrja e hershme (EI) është një sistem mbarëkombëtar që ofron shërbime të koordinuara për prindërit e fëmijëve të kualifikuar, nën moshën 3-vjeçare me vonesa në zhvillim ose me aftësi të kufizuara. EI është pjesë e sistemit të mbështetjes "Help Me Grow". Këto shërbime dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara zhvillimore ofrohen në nivel qarku nga bordi i qarkut tuaj lokal për aftësitë e kufizuara zhvillimore (CBDD). Ky i fundit përcakton përshtatshmërinë, vlerëson nevojat tuaja dhe koordinon se cilat shërbime mund t'ju mbështesin më mirë. Klikoni këtë lidhje për më shumë informacion mbi [kualifikueshmërinë për ndërhyrje të hershme](#).
- "The Ohio Department of Education" po përgatit gjithashtu një udhërrëfyes për fëmijërinë e hershme për t'ju ndihmuar të kuptoni se si funksionon arsimimi i fëmijës tuaj në këtë moshë të re. Shikoni faqen e internetit të Departamentit pas disa muajsh për të parë këtë burim të ri.
- "The Ohio Department of Education" disponon mjete që mbështesin familjet dhe shkollat në [planifikimin e hershëm të tranzicionit](#). Për shembull, mjete të tilla si "[Charting the LifeCourse](#)" mund të ndihmojnë familjet që të fillojnë të flasin për tranzicionin.



Fëmija juaj është në klasat 6-8

- Një [Plan i Suksesit të Studentëve](#) është një proces i fokusuar te studentët për të mbështetur studentët dhe familjet e tyre për të kuptuar kërkesat akademike për arritjen e një objektivi të karrierës. Nëse fëmija juaj rrezikon të braktisë shkollën, distrikti shkollor i fëmijës suaj duhet të krijojë një plan suksesi studentor për të.
- Përpara se distriktet shkollore të krijojnë planin e suksesit të studentëve, ata duhet t'ju ftojnë në një takim për të ndihmuar në zhvillimin e planit. Distrikti shkollor duhet gjithashtu të ndajë me ju Planin e Suksesit të Studentit për fëmijën tuaj sapo të hartohet.



[KTHEHEMI TË UDHËRRËFYESI](#)

Udhërrëfyes

PËR FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË MOSHAVE 3-21 VJEÇ



Fëmija juaj po mbush moshën 14-vjeçare

- Distrikti shkollor i fëmijës suaj duhet të krijojë një plan tranzicioni për fëmijën tuaj, Seksioni 5 i Planit [Individual Arsimit \(PIA\)](#). 
- Distrikti shkollor i fëmijës suaj do të mbledhë informacion për fëmijën tuaj përmes vlerësimeve të [tranzicionit të përshtatshme për moshën \(AATA\)](#). Ky informacion përfshin preferencat, interesat, nevojat dhe pikat e forta të fëmijës suaj – ky informacion nganjëherë njihet si PINS. 
- Distrikti shkollor i fëmijës suaj duhet të përdorë informacionin e mbledhur përmes procesit AATA për të përgatitur planin e tranzicionit. Plani i tranzicionit të fëmijës suaj do të përfshijë informacione për sa vijon:
 - shërbimet e tranzicionit,
 - dega(ët) e studimit,
 - objektivat pas arsimit të mesëm që lidhen me formimin dhe arsimin
 - objektivat pas arsimit të mesëm që lidhen me aftësitë e jetesës së pavarur (nëse është e përshtatshme) , dhe
 - objektivat pas arsimit të mesëm që lidhen me punësimin e integruar konkurrues.




Fëmija juaj po hyn në klasën e 9-të

- Duke filluar nga klasa e 9-të dhe duke vazhduar deri në diplomim, shkolla e fëmijës suaj duhet të punojë me fëmijën tuaj (dhe t'ju përfshijë gjatë këtij procesi) për të zhvilluar një [plan diplomimi të shkollës së mesme](#).
- Studentët duhet të përmbishin shumë kërkesa për përfundimin e shkollës së mesme. Plani i diplomimit duhet të përcaktojë se çfarë duhet të bëjë fëmija juaj për të përmbushur këto kërkesa. Ndërsa plani përditësohet çdo vit, ai duhet të dokumentojë suksesin (ose mungesën e tij) të fëmijës suaj në përmbushjen e kërkesave të diplomimit. Nëse fëmija juaj rrezikon të mos diplomohet për shkak se ka mbetur pas në përmbushjen e një ose disa kërkesave, distrikti shkollor duhet t'ju njoftojë.

[KTHEHEMI TË UDHËRRËFYESI](#)

Udhërrëfytes

PËR FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË
KUFIZUARA TË MOSHAVE 3-21 VJEÇ



PIKA E SHËRBIMIT 1

Plka e shërbimit 1 përmban informacione që bëhen veçanërisht të rëndësishme për fëmijën tuaj rreth moshës 14-vjeçare. Lidhja e parë do t'ju çojë te një udhëzues planifikimi për Vlerësimin e Tranzicionit të Përshtatshëm për Moshën (mund ta njihni si AATA). Një vlerësim i tranzicionit të përshtatshëm për moshën është i rëndësishëm për të ndihmuar fëmijën tuaj të marrë arsimin, trajnimin dhe mbështetjen që i nevojitet për të zhvilluar njohuri dhe aftësi që do t'i ndihmojnë ata të arrijnë qëllimet e tyre të jetës. Te lidhja e dytë, lista e kontrollit e treguesit 13, ofron pyetje që mund t'ju udhëzojnë ju dhe ekipin e planit individual arsimor (PIA) të fëmijës suaj që të përcaktojnë nëse ka objektiva të përshtatshme pas arsimit të mesëm në fushat e formimit, arsimit, punësimit dhe aftësive të jetesës së pavarur. Këto mjete mund t'ju ndihmojnë të mbështesni fëmijën tuaj ndërsa përgatitet për jetën pas shkollës së mesme.

- [Udhëzues për planifikimin e vlerësimit të tranzicionit të përshtatshëm për moshën](#)
- Lista e kontrollit e treguesit 13 - *(Lidhja do të jetë e disponueshme së shpejti)*



Fëmija juaj është 16 vjeç

- Kur fëmija juaj mbush 16 vjeç, nëse ka qenë i kualifikuar për shërbime sipas bordit të qarkut për aftësitë e kufizuara zhvillimore, kualifikueshmëria e tij nuk bazohet më në Instrumentin e Përcaktimit të Kualifikueshmërisë së Fëmijëve në Ohio (COEDI). Kualifikueshmëria e tyre tashmë përcaktohet përmes Instrumentit të Përcaktimit të Kualifikueshmërisë në Ohio (OEDI). Nëse fëmija juaj po merr këto shërbime dhe ju shpresoni t'i vazhdoni ato, [Udhëzuesi i përdorimit të OEDI](#) mund t'ju ndihmojë gjatë procesit.

[KTHEHEMI TË UDHËRRËFYTES](#)

TRANZICIONI NË CIKLIN DYTËSOR

Udhërrëfyes

PËR FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË
KUFIZUARA TË MOSHAVE 3-21 VJEÇ



Plka e shërbimit 2

Pika e shërbimit 2 përmban dy lidhje që ofrojnë informacion në lidhje me marrjen e një karte identiteti të Ohio dhe të lejes së drejtimit të automjetit. Kartat e identitetit me fotografi janë vetëm për qëllime identifikimi dhe mund të ndihmojnë në gjetjen e fëmijës suaj, në rast se humbet. Nuk ka moshë minimale për një kartë identiteti në Ohio. Leja e përkohshme e drejtimit të automjetit mund të merret në moshën 15 vjeç e gjysmë dhe një leje drejtimi për një periudhë prove mund të merret gjashtë muaj pas marrjes së lejes së drejtimit.

- [ID dhtetërore](#)
- [Leja e drejtimit të automjetiit](#)



Fëmija juaj është 17 vjeç

- Moshë madhore është moshë në të cilën një individ konsiderohet i rritur. Moshë madhore në Ohio është 18 vjeç .
- Të paktën një vit para se fëmija juaj të arrijë moshën madhore, distrikti shkollor duhet t'ju informojë ju dhe fëmijën tuaj se të drejtat e IDEA do t'i transferohen fëmijës tuaj në moshën 18 vjeç. PIA i fëmijës suaj duhet të tregojë se ju dhe fëmija juaj keni qenë të informuar për të drejtat e tyre . Distrikti juaj shkollor ka detyrimin që të vazhdojë të mbështesë fëmijën tuaj në moshën 18-vjeçare nëse është e nevojshme.

[KTHEHEMI TË UDHËRRËFYESI](#)

Udhërrëfyes

PËR FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË
KUFIZUARA TË MOSHAVE 3-21 VJEÇ



Fëmija juaj është 18 vjeç

- Fëmija juaj ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të bërë vetë zgjedhje të caktuara ligjore dhe arsimore.



Fëmija juaj ka mbërritur në destinacionin e shkollës së mesme

Fëmija juaj është gati për t'u nisur në rrugëtimin e moshës madhore. Bagazhi o tyre është plot me burime për t'i mbështetur gjatë udhëtimeve të tyre.

- Kur fëmija juaj mbaron ose lë shkollën e mesme, distrikti shkollor i fëmijës suaj duhet të ofrojë një [një përmbledhje të performancës akademike dhe funksionale të fëmijës suaj](#). Kjo përmbledhje duhet të përfshijë gjithashtu rekomandime që mund ta ndihmojnë fëmijën tuaj në arritjen e objektivave të tij pas arsimit të mesëm.
- Ju mund të mbështesni suksesin e fëmijës suaj pas arsimit të mesëm duke e ndihmuar atë të përparojë sipas rekomandimeve që i janë dhënë.



Fëmija juaj është 22 vjeç

- Fëmija juaj nuk është më i kualifishuar për arsim të përshtatshëm publik falas (FAPE) sipas Aktit Arsimor për Individët me Aftësi të Kufizuara (IDEA). Nëse fëmija juaj mbush 22 vjeç gjatë vitit shkollor, politika e distriktit shkollor do të përcaktojë nëse fëmija juaj mund të përfundojë vitin shkollor në atë distrikt.

[KTHEHEMI TË UDHËRRËFYESI](#)